



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 3.09.2018 ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 3 shtator – 12 tetor 2018.
Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 3 – 21 shtator 2018.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim /
	Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Erion Braçe -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Genc Pollo - Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian

Marrin pjesë:

Mimoza Pano - Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Të nderuar anëtarë të Konferencës së Kryetarëve, duke Ju uruar një fillim të mbarë në këtë sesion të ri parlamentar, po hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me rend dite miratimin e programit të punës së Kuvendit për periudhën 3 shtator deri 12 tetor 2018 dhe miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 3 – 21 shtator 2018.

Me projektprogramin dhe projektkalendarin jeni njohur në rrugë elektronike.

Projektprogrami përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend si projektligje, projektvendime, raporte vjetore të 2 institucioneve që kanë mbetur për të raportuar në Kuvend etj. Pjesë e këtij programi do të jenë edhe projektligjet e depozituara në Kuvend më datën 30 gusht. Njëri nga projektligjet, “Për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve” është kërkuar me procedurë të përshpejtuar. Të gjitha materialet i keni përpara.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Janë parashikuar 4 seanca plenare përkatësisht në datat:

3 shtator 2018, ora 17.00 (e hënë) – hapja e sesionit ku do të miratohet projektprogrami dhe projektkalendari. Përsa i përket orës 17.00 apo 18.00 do ta vendosim bashkërisht.

6 shtator 2018 ora 10.00 (e enjte), 13 shtator 2018, ora 10.00 (e enjte), ndërsa për seancën e fundit ka dy data 17 shtator e hënë ose 20 shtator e enjte, ora 10.00. Mendoj se data 20 shtator është më e përshtatshme, duke marrë parasysh dhe kërkesën e komisioneve për t’u lënë kohë për të punuar.

Para se të filloj diskutimin për këto dokumente, dua të sjell në vëmendjen tuaj tre probleme, që i vlerësoj të rëndësishme për mbarrëvajtjen e punës së Kuvendit në komisione dhe në seancë plenare:

Së pari, lidhur me shqyrtimin e projektligjeve që janë parashikuar në kalendar vetëm si “punë në komisione”, ku disa prej tyre kanë kohë që janë depozituar në Kuvend. Përmend këtu shqetësimin e ngritur nga z. Vasili për nismën e LSI-së për projektligjin e konçensioneve që ende nuk është shqyrtuar nga komisionet edhe pse kjo nismë ka qenë planifikuar herë pas here në kalendarët 3-javore për shqyrtim e miratim. Do të kërkoja nga kryetarët e komisioneve që kur të bëjnë programin e tyre të punës, të mos fokusohen vetëm tek projektligjet që janë parashikuar për në seancë plenare, por të programojnë edhe shqyrtimin e projektligjeve që janë parashikuar për punë në komisione, sepse ato do të jenë baza për kalendarët e ardhshëm për planifikim në seancë plenare.

Së dyti, komisioni i Ligjeve, si komision përgjegjës për projektligjet e reformës në drejtësi, duhet të përshpejtojë punën për të mbyllur shqyrtimin e projektligjeve të depozituara me qëllim kalimin sa më shpejt në seancë plenare për miratim, mundësisht brenda këtij sesi.

Së treti, komisioni i Ligjeve ka ngritur një shqetësim mbi nivelin e përfaqësimit të ministrive në mbledhjet e komisionit të Ligjeve, por jo vetëm edhe në komisionet e tjera. Për një përfaqësim sa më të mirë dhe përfshirjen në debatet aktive dhe konstruktive në komisione, është e domosdoshme pjesëmarrja e përfaqësuesve të ministrive, jo vetëm në nivel teknik por edhe në nivel politik, pasi në shumë raste specialistët e ardhur në Kuvend nga ministrinë kanë qenë në nivel drejtor drejtorie apo shef sektori. Prandaj zonja Zëvendëskryeministre, si përfaqësuese e ekzekutivit për marrëdhëniet Qeveri-Parlament, lutem të merrni masat e nevojshme që të mos përsëriten më të tilla raste në marrëdhëniet ministër-komision.

Një shqetësim i dytë që ngrihet përsëri për Qeverinë nga komisioni i Ligjeve është për relacionet shpjeguese që shoqërojnë projektligjet që depozitohen në Kuvend. Ato duhet të jenë shumë më të detajuara dhe të përmbajnë informacione të plota për ndikimin social, ekonomik, financiar e mjedisor që do të kenë këto ligje të qytetarët. Edhe për këtë zonja Zëvendëskryeministre, ju lutem mbani në konsideratë sugjerimet e anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve. Shkresa besoj se Ju ka ardhur, por edhe nëse nuk ka ardhur, duhet t’iu vijë.

Lidhur me programin dhe kalendarin çfarë sugjerimesh keni për materialet e paraqitura? Kush e dëshiron fjalën? Po zoti Shalsi.

Eduard Shalsi – Faleminderit zoti Kryetar. Janë dy projektligje që janë parashikuar për t’u shqyrtuar në komisionin e Veprimtarive Prodhuese, ndërkohë që do të sugjeroja se datat e seancave parlamentare që parashikohen, respektivisht në datat 13 dhe 17 dhe 20 shtator, të

shtyhen nga këto data dhe të vendosen punë në komisione. Bëhet fjalë për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, që është parashikuar në datën 17 ose 20 sipas datës fikse që ne do përcaktojmë, dhe e dyta Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 10849, datë 27.07.2018, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: “Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar” që është parashikuar në datën 13 shtator, do të doja ta vendosnit punë në komision. Pra, për të dyja këto do të kërkoja shtyrjen e datës së shqyrtimit në seancë dhe vendosjen punë në komision siç është dhe për një pjesë të projektligjeve të tjera. Faleminderit.

Edmond Spaho – Zoti Kryetar, dëshiroj të ngre 2 – 3 çështje të cilat shpresoj të jenë po aq të rëndësishme sa ato që ngritët Ju. Duke marrë shkas që fillojmë një sesion të ri parlamentar dhe parlamenti është në funksion të të gjithave zhvillimeve ekonomike, shoqërore dhe politike të vendit dhe përpiqet për një qeverisje sa më të mirë që të jetë e mundur. Për fat të keq po ndodh e kundërta dhe desha të shpreh shqetësimin e madh për kriminalizimin e qeverisjes dhe shtrirjen e krimit në mënyrë masive në të gjithë territorin e vendit. Mjafton t’i referohesh ngjarjeve të ditëve të fundit për të kuptuar nivelin skandaloz në të cilin krimi është shtrirë në qytetet kryesore të vendit dhe lidhjen e tij me Qeverinë. Po të mos ishin lidhjet me Qeverinë nuk do të kishte arsye që ne të jetojmë ngjarje si atë të qytetit të Shkodrës, apo të Elbasanit të disa javëve më përpara, apo në Vlorë, apo sikurse ishte rasti tjetër skandaloz i goditjes së shtëpisë së familjes së gazetares Klodiana Lala, që i vuri kapakun sjelljes së vazhdueshme permanente të gjeneruar nga Kryeministri në raport me mediat. Kjo klimë, kjo kulturë që Kryeministri ka kultivuar gjatë gjithë kësaj periudhe duke shpallur armike median për interesat e tij politike, na çoi në ngjarje të tilla të cilat nuk kanë ndodhur jo më në Evropë që ka kohë që kanë marrë fund veprime të tilla, por as në rajonin e Ballkanit ku ne jetojmë.

Në këtë kontekst të kriminalizimit të qeverisjes dhe të lidhjeve të ngushta të saj me botën e krimit, tërheq vëmendjen edhe ndaj Jush, si Kryetar i Parlamentit, për përsëritjen, rizbulimin e fenomeneve të cilat ne i patëm gjatë legjislaturës së shkuar. Prezencën e njerëzve të kriminalizuar apo të përfaqësuesve të popullit me lidhje me botën e krimit. Këtu dua të shpreh keq ardhjen e madhe se si mundet Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste të ketë lidhje familjare me një person që është dënuar me 21 vjet burg për dy arsye, për krim të organizatave kriminale dhe për transport ndërkombëtar droge.

Po kështu edhe rastin e deputetit Ergys Cyrbja, të cilit iu publikuan biseda me përfaqësues nga bota e krimit, përfaqësues të bandës së Shullazit. Sikurse rasti i shkuar që sapo përmenda për Kryetarin e Grupit të Partisë Socialiste që ka të bëjë me Aldo Baren, kryetarin e një nga bandat më të rrezikshme në Shqipëri, bandës së Lushnjës.

Ne kemi miratuar një ligj për dekriminalizimin në legjislaturën e shkuar. Është detyra jonë që t'i përmbahemi kërkesave të këtij ligji, që përfaqësues të botës së krimit të mos të kenë vend në Parlament. Për fat të keq megjithëse regjistrimet u publikuan, prokuroria nuk ka ndërmarrë deri më sot asnjë hetim për këtë anëtarë të Parlamentit, që jep e merr dhe i siguron mbrojtje politike dhe është bashkëpunëtorë në veprimet që kryen banda e Shullazit. Pavarësisht së çfarë bën prokuroria, është në detyrën tonë si përfaqësues të legjislativit të kërkojmë zbatimin e ligjit të dekriminalizimit dhe vënies përpara përgjegjësisë të këtyre individëve.

Po kaq aktuale mbeten lidhjet me botën e krimit të ish ministrit Saimir Tahiri dhe ministrit aktual zotit Fatmir Xhafaj. Është bërë zakon në Shqipëri që ngjarja zë ngjarjen dhe fillojnë e harrohen, prandaj ka dalë dhe ajo shprehja që çudia më e madhe tek ne 3 ditë zgjat. Duket sikur iu kthyer normalitetit në raport me Saimir Tahirin dhe Fatmir Xhafën, në fakt nuk është kështu. Dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj intervistat e sotme të zotit Krichbaun i cili është përfaqësues i Komisionit të Lidhjeve me Europën dhe Integritetit në Bundestag, apo të Sebastien Frade, i cili është reporteri për Ballkanin Perëndimor në Komisionin që kanë ngritur në Bundestag për zgjerimin, ku cituan edhe një herë që qëndrimi i zotërinjve, i zëvendëskryetarit të grupit parlamentar Wade Paul dhe i reporterit Sebastien Frade, në lidhje me Fatmir Xhafën, nuk është qëndrim personal, por është qëndrim i të gjithë grupit parlamentar të CDU CSU- së. Kjo do të thotë se është e pa imagjinueshme se si një ministër që ka vëllain të dënuar për krijim organizatash kriminale dhe trafik ndërkombëtar droge të vazhdojë e të mbajë postin.

Përse ndodhin të gjitha këto?

Tashmë e kemi shprehur qëndrimin tonë. Ndodhin për shkak të Edi Ramës, ai është koka, frymëzuesi, orientuesi, zbatuesi dhe njeriu që i jep përkrahje politike si njerëzve që ka futur në Parlament si përfaqësues të botës së krimit, apo si ndërlidhës me botën e krimit, ashtu dhe bandave të cilat operojnë në qytetet kryesore të vendit, me të cilat Ai bashkëpunon ngushtë, sidomos kur i nevojiten vota. Me sa duket objektivi i radhës është qyteti i Shkodrës, ku shohim që si rrjedhojë e kësaj politike qytetin e kanë marrë në dorë bandat e krimit. Nuk ka nevojë të

themi se sa veta u vranë e sa janë të rrëmbyer e sa janë plagosur gjatë ditëve të fundit, për të kuptuar që situata është tërësisht jashtë kontrollit.

Problemi i dytë, që desha të ngre ka të bëjë me reformën në drejtësi, dështimin e saj tërësor dhe rolin thellësisht negativ të mazhorancës në tentativa për ta kapur këtë sistem. Sot zoti Kryetar duhet të jemi të shqetësuar dhe në radhë të parë Ju, si Kryetar i Kuvendit, që jemi pa gjykata. Pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë dhe pa Gjykatë Apeli. Jemi vendi i vetëm në botë, nuk di të ketë ndonjë vend tjetër, ku tre gjykata kryesore të vendit nuk funksionojnë. Nuk funksionojnë për shkak të qëndrimit të mazhorancës, e cila eci sipas një projekti të dizenuar qartë, me objektiva për t'i kapur këto institucione dhe për të emëruar njerëzit e tyre, e cila u shpreh në hartimin, miratimin dhe zbatimin në mënyrë të njëanshme të 6 ligjeve të Reformës në Drejtësi.

Ku ndodhemi sot! Sot ndodhemi jo vetëm pa Gjykatë të Lartë, pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë Apeli, por jemi dhe pa KLGJ, pa KLP dhe pa Këshill të Emërimeve në Drejtësi, pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme që bëni për të pasur aplikime dhe plotësimin e këtyre organeve. Dëshiroj të nënvizoj gjithashtu përpjekjet që po bëni për të kapur këto institucione për të ashtuquajturin proces të Vettingut. Janë 11 prokurorë dhe gjykatës të cilët sikurse i ka evidentuar media, jo opozita, media, operacioni ndërkombëtar i monitorimit, komisionerët dhe organizma të tjera. Pra, gjyqtarë dhe prokurorë të cilët kanë probleme thelbësore me ligjin e Vettingut, probleme pasurore, probleme të vendimeve që kanë marrë, probleme të lidhjeve me botën e krimit. Shqetësimi ynë është dukshëm dhe qartë që këta do të jenë në mbështetjet tuaj politike, njerëzit që do të plotësojnë këto organizma, në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit, KLGJ, KLP dhe KED, duke treguar edhe një herë që Reforma në Drejtësi është e dështuar dhe farsë. Objektivi ishte që këto organe të bien në dorë të mazhorancës në mënyrë që t'i sigurojnë mbrojtjen nga pushteti gjyqësor, për këtë mënyrë si po qeveris Rama në bashkëpunim të ngushtë dhe ortakëri me krimin.

Çështja e fundit që desha të ngre ka të bëjë me ligjin “Për teatrin”. Ju tashmë jeni koshient për qëndrimet tona dhe të qytetarëve. Ne njohim edhe qëndrimin tuaj që insistoni për ta sjellë atë në Parlament. Unë uroj që ta sillni, por nëse e sillni e vetmja zgjidhje është që të miratoni Dekretin e Presidentit të Republikës dhe të rrëzoni ligjin e Qeverisë dhe të Edi Ramës për të realizuar një aferë rreth 250 milion euro të filluar këtu e 20 vite më parë. Në të kundërt, nëse nuk keni ndërmend që të rrëzoni ligjin dhe të miratoni dekretin apo të kundërtën, të miratoni dekretin dhe të rrëzoni ligjin, e vetmja rrugë që keni është ajo që ju tha zoti Basha

para 3-4 ditësh, që mos e sillni ligjin në Parlament sepse do kontribuoni për krijimin e një klime politike e cila nuk dihet se ku do përfundojë. Faleminderit.

Fatmir Mediu – Zoti kryetar unë nuk do desha të përsërisja ato çfarë tha zoti Spaho, por duhet t'i rikthehem edhe njëherë një çështjeje, që është në gjykimin tim shumë e rëndësishme dhe i tejkalon ndjesitë tona politike. Është çështja e asaj çfarë po ndodh me sistemin gjyqësor në Shqipëri. Mungesa e Gjykatës Kushtetuese është një nga problemet më të mëdha, e paprecedentë, nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër, një problem shumë i madh me mënyrën e funksionimit të shtetit shqiptar për të mos thënë që ka rënë për sa kohë ka rënë gjyqësori, po ashtu edhe Gjykata e Lartë dhe pres që e njëjta gjë të ndodhi edhe me Gjykatat e Apelit.

Mendoj që të paktën të lëmë mënjatë të gjitha debatet politike dhe të analizojmë, ka ardhur koha se përse jemi në këtë situatë dhe kush janë rrugët për ta kapërcyer këtë situatë në të mirë të interesave të qytetarëve dhe funksionimit të shtetit. Mendoj që duhet të kemi një diskutim thellësisht do të thosha, qoftë në nivel teknik, qoftë edhe në asistencë ndërkombëtare për të bërë atë që është më e mira duke bërë mendimet të përkohshme për të kaluar radhën por për të parë në thelb sesa funksionon Kushtetuta Shqiptare dhe sa garantojmë ne në një pushtet gjyqësor të pavarur. Mendoj që është një situatë jashtëzakonisht problematike, e cila duhet të na preokupojë si qytetarë dhe si deputetë se në qoftë se do vazhdojmë në këtë mënyrë, as më shumë e as më pak, ajo që do të triumfojë në Shqipëri dhe do të bëhet gjithnjë edhe më vendimmarrëse edhe më dominante edhe më kontrolluese do të jetë pa dyshim struktura e krimit të organizuar në Shqipëri. Opozita ka pasur qëndrimet e veta në raport me çështjet, siç e përmendi zoti Spaho me 6 ligjet. Çështjet e tjera që mund të kenë dalë në këtë proces është mirë që të kemi një vlerësim të përbashkët, jashtë ndjesive momentale politike, por një qartësi të plotë se çfarë duhet të bëjmë. Po ashtu, mendoj që është detyrë e këtij Kuvendi për të parë sesi zbatohet Kushtetuta apo ligjet që kemi miratuar vetë. Rastet që përmendi zoti Spaho për një vlerësim, domethënë me 2 standarte në procesin e Vettingut duhet të jenë një preokupim dhe shqetësim i yni. Pavarësisht se ka struktura apelimi apo struktura monitorimi, unë mendoj që në koshiençën tonë politike, në përfaqësimin tonë parlamentar është më se e detyrueshme që ne të mos jemi larg procesit, sepse mendojmë që kështu po zgjidhim, dhe duke qenë brenda procesit në rrugë të tjera për të bërë atë që duam, siç po ndodh me qeverinë, por të shikojmë që në këtë proces të Vettingut, të cilin e kemi konsideruar të gjithë të rëndësishëm, në mënyrë të padiskutueshme të ketë një transparencë absolute dhe kriteret e vlerësimit të mos jenë me

standarde dyfish. E theksoj edhe njëherë që ne sot jemi në një situatë të pa precedentë. Të mos bëhemi qesharakë, as mos të pranojmë të na trajtojnë si qytetarë të dorës së dytë në mënyrë të turpshme kushdo që të jetë, e thonë se këta shqiptarët çdo gjë e pranojnë, çdo gjë mund të ndodhë me shqiptarët. Nuk ka asnjë vend që të mund të funksionojë pa pushtet gjyqësor dhe kjo nuk duhet të ndodhë me ne. Ka nga ata që thonë se pas një viti do ndërtohet KLGJ-ja, do ndërtohet KLP-ja, do fillojë të punojë dhe Gjykata Kushtetuese, do ndërtohet dhe Gjykata e Lartë. Në gjykimin tim shteti do të thotë që ka rënë dhe për më tepër kur në këtë proces është përfshirë ekzekutivi ky është një lloj grushti shteti i ekzekutivit mbi pushtetet e tjera për të kontrolluar atë që nuk i takon dhe për të ushtruar autoritetin e tij në kundërshtim me ligjin dhe me Kushtetutën. Prandaj mendoj që ne nuk kemi asgjë më të rëndësishme se ajo çfarë duhet të bëjmë që të kemi një shtet funksional bazuar mbi parimet kushtetuese, për të bërë Kushtetutën e vendit funksionale, ose le të themi që nuk kemi më Kushtetutë, nuk kemi më asnjë mundësi për të gjykuar në mënyrë të përbashkët, në respekt të ligjeve, të Kushtetutës dhe interesave të qytetarëve, por do të ecim në politika klanore të një Republike bananesh.

Gramoz Ruçi – Dëshiron njeri të shprehet? Po fjalën e ka zoti Balla.

Taulant Balla – Në fakt, zoti kryetar, kolegë e kolege deputetë, projekt programi i punimeve që miratojmë sot ditën e fundit të tij konvergon për afërsisht me ditën e përfundimit të mandatit të Komisionit të Reformës Zgjedhore. Mes tetori është mandati që i kemi ri dhënë Komisionit të Reformës Zgjedhore e për pasojë apeli im i vetëm në këtë Konferencë Kryetarësh është që në frymën edhe të rekomandimeve të Këshillit Europian të 28 qershorit, ne duhet patjetër të kemi gati nga dy bashkëkryetarët dhe nga të gjithë komisioni i Reformës Zgjedhore dhe sa më shpejt draftet e konsultuara. Dua të informoj Konferencën e Kryetarëve që dy bashkëkryetarët në fakt kanë rakorduar, por që draftet finale të marrin edhe vlerësimet e Komisionit të Venecias, po të kemi parasysh që Komisioni i Venecias i ka të përcaktuara sesionet e veta plenare, në tetor i pari dhe në fillim të dhjetorit i dyti për këtë vit. Shpresat që të kapin të parin janë të vogla, por maksimalisht fillim dhjetorin duhet ta kapim me qëllim që të respektojmë dhe standardin e normave më të mira dhe praktikave më të mira të ODHIR-it, që ndryshimet në Kodin Zgjedhor nuk mund të bëhen më vonë sesa 6 muaj nga dekretimi i zgjedhjeve, po të kemi parasysh gjithashtu që, shumë shpejt, Presidenti i Republikës hyn në afatet nga 9 deri në 6 muaj të dekretimit të datës të zgjedhjeve të Pushtetit Vendor të vitit të ardhshëm.

Kjo Konferencë Kryetarësh dhe ky sesion i ri parlamentar që fillojmë sot, duhet të ketë në fokusin e vet pikërisht përfundimin në kohë të Reformës Zgjedhore, ndërkohë që lidhur me propozimin që bëri zoti Shalsi për shqyrtimin e dekreteve sigurisht Kuvendi sot njihet zyrtarisht, në kuptimin sepse dekreti ka ardhur pasi Kuvendi është shpërndarë. Le të vendosim datën 20 shtator, jam dakord, që mos të jetë data 13 shtator. Pastaj nëse komisionet nuk e kanë shqyrtuar, por nëse e lëmë për punë komisioni i bie që të mos hyjë fare gjatë këtij kalendari. Shërbimi i Seancës të na sqarojë.

Mimoza Pano – Duke qenë “punës në komisione”, e pa planifikuar për në seancë plenare, nëse komisioni arrin ta përfundojë gjatë kësaj kohe dhe bëhet gati për seancën e datës 20 shtator, me kërkesë të Kryetarit të Grupit mund ta fusim në rendin e ditës të seancës në fjalë.

Taulant Balla – Po e lëmë në datën 20 shtator. Po nuk u bë, ai spostohet pastaj, praktikisht nuk e dimë nëse komisionet do kërkojnë kohë. Faleminderit.

Gramoz Ruçi – Ka ndonjë tjetër për të folur? Jeni dakord me programin, me kalendarin? Atëherë, miratohet projektprogrami dhe projektkalendari. Unë thashë ka kundër? Ju thatë jo. Ato nuk ishin konsiderata. Kryetari i Grupit foli. Jeni dakord me ato që thamë?

Edmond Spaho – Unë e bëra të qartë, ju thashë që silleni dekretin sa më parë që të jetë e mundur.

Gramoz Ruçi – Juve thatë mos e sillni, në mënyrë që në qoftë se e sillni, silleni kështu siç them unë.

Edmond Spaho – Unë ju thashë ...

Gramoz Ruçi – Mos e sillni...

Edmond Spaho – Uroj ta sillni dhe nëse e sillni keni vetëm një alternativë të miratoni Dekretin dhe të hidhni poshtë ligjin.

Gramoz Ruçi – Për draft-programin, draft-kalendarin?

Edmond Spaho – Nëse nuk keni ndërmend ta hidhni poshtë ligjin dhe me sa duket nuk keni ndërmend, më mirë mos e sillni thashë, sepse mos e sillni në kuptimin që hiqeni nga kalendari, por edhe nga programi, nëse nuk keni ndërmend ta rrëzoni ligjin. Me sa shoh edhe nga propozimi i zotit Shalsi edhe nga qëndrimet tuaja juve jeni futur në një dilemë të madhe çfarë të bëjmë me këtë ligj që na zuri këmbët dhe filloni tani të shtyni nga 13 në 20, nuk kemi

kohë për ta shqyrtuar, se çfarë do shqyrtoni ju e dini. Me të tilla akrobacira nuk jemi dakord dhe nuk japim miratimin as për draft-programin e as për draft-kalendarin.

Gramoz Ruçi – Atëherë nuk ka konsensus. Këto dokumente i drejtohen seancës plenare për miratim. Atëherë që ta mbyllim, lidhur me orën e seancës së sotme në 17:00 apo 18:00, kur e doni?

Taulant Balla – Po me që është njoftuar në 17:00...

Gramoz Ruçi – Dakord, në 17:00. Seanca do zhvillohet në orën 17:00. Lidhur me precedentët për deklarim në seancën e hapjes së sesionit, kryetarët e grupeve në qoftë se dëshirojnë deri në 10 minuta të shprehin konsideratat e tyre për fillimin e sesionit bashkë me mua. 10 minuta unë dhe 10 minuta kryetarët e grupeve. Dëshironi kryetarët e grupeve? Atëherë mbledhja mbyllet. Në orën 17:00 në sallë.

MBLEDHJA MBYLLET